

**shpall:**  
**KONKURS**  
**Për plotësimin e vendit të lirë të punës**

**Udhëheqës i zyrës ligjore në RTK (Nr. 2031)**

**1 pozitë**

**Detyrat**

- Udhëheq, organizon dhe mbikëqyr punën e njësisë juridiko-ligjore;
- Përgatit, analizon dhe interpreton ligjet dhe aktet nënligjore në të gjitha fushat juridike;
- Ofron këshilla juridike mbi aplikimin e drejtë të normave ligjore, në interes të kompanisë;
- Mbron interesat juridike të RTK-së;
- Me autorizim, përfaqëson RTK-në në të gjitha gjykatat dhe në të gjitha çështjet kontestuese;
- Përkujdeset për mbrojtjen e pronës intelektuale dhe të drejtave autoriale të RTK-së;
- Ofron ndihmë profesionale për iniciimin e procedurës disiplinore dhe udhëheqjen e procedurës paraprake;
- Përgatit dhe realizon të gjitha llojet e vendimeve të marra nga strukturat udhëheqëse;
- Mbikëqyr në aspektin ligjor procedurat e konkurseve dhe shpalljeve.

**Kushtet**

- Kualifikimi superior profesional;
- Katër (4) vite përvojë pune në punë të ngjashme;
- Njohuri e punës në kompjuter;
- Njohuri e gjuhës angleze;
- Aftësi për të punuar qetë, nën presion dhe si pjesë e ekipit;
- Përkushtimi ndaj shërbimit publik informativ;
- Ndershmëria, kreativiteti dhe aftësia për të punuar me vetiniciativë.

*Për këtë vend të punës është e paraparë kontrata e punës me kohë të caktuar, me periudhë provuese prej tre muajve.*

**Kandidatët e paraqitur për këtë pozitë duhet:**

- të jenë qytetar të Kosovës - të regjistruar sipas dispozitave ligjore të Republikës së Kosovës;
- të mos kenë angazhime, biznese, etj. të cilat mund të konsiderohen si konflikt interesi, sipas Ligjit për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

**Kandidatët duhet të dorëzojnë:**

- ✓ një CV;
- ✓ dëshmitë e kualifikimit të noterizuara;
- ✓ certifikatë e lindjes;
- ✓ një kopje të letërnjoftimit;
- ✓ një letër motivuese;
- ✓ dy referenca;
- ✓ dëshmi të përvojës;
- ✓ certifikatë nga Gjykata që nuk jeni nën hetime (të lëshuar gjatë muajit të fundit para aplikimit);
- ✓ aplikacionin i cili duhet të shkarkohet nga ueb-faqja e RTK-së: <https://www.rtklive.com/sq/docs/2022-02-05/231.doc>

Dokumentacioni i kompletuar duhet të dorëzohet i skenuar, në mënyrë elektronike, përmes e-mail adresës: [konkurs@rtklive.com](mailto:konkurs@rtklive.com), prej 09.09.2022 deri më 23.09.2022 në orën 16:00.

**Vetëm aplikacionet dhe dokumentet e dorëzuara përmes postës elektronike do të pranohen.**  
**Aplikacioni dhe dokumentacioni i pakompletuar nuk do të merren në konsiderim.**